


01-1365



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 5 pika 1.2 dhe 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 22 & 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, dt. 21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 dhe nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrative të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 350/02-166770/19 dt. 12.07.2019, së Drejtorisë së Arsimit, Komuna e Prishtinës, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor dhe lejimin e ndërtimit të Institucionit Parashkollor, në lagjen 'Dardania', në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative me datë 20.09.2019 merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KUSHTVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore, kërkuarësit Drejtoria e Arsimit, Komuna e Prishtinës, sipas kërkesës 05 nr. 350/02-166770/19 dt. 12.07.2019, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor për ndërtimin e ndërtesës së Institucionit Parashkollor me etazhitet P+1, në kuadër të Planit Rregullues "Dardania" dhe Planit Zhvillimor Urban, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 7457-0, 7458-0 dhe 7455-1, ZK Prishtinë.

II. Lokacioni për të cilën caktohen kushtet ndërtimore për ndërtimin e ndërtesës, gjendet në kuadër të Planit Rregullues "Dardania", miratuar me Vendimin e KK Prishtinë, të miratuar me Vendimin 01 nr. 110-710 të dt. 05.06.2009, dhe sipas këtij plani kjo zonë është e paraparë për ndërtimin e 'çerdhës / institucion parashkollor'.

Njëherit, lokacioni në fjalë shtrihet edhe në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 035-181427 dt. 24.09.2013, dhe sipas këtij plani kjo zonë është e paraparë me destinim 'Ndërtim i lartë mix'.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit / parcelave, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqet, pronarët & klasa e kualitetit të parcelave kadastrale, janë:
 - nr. 7457-0; S=24,126.00m²; P.SH. KK Prishtinë; Tokë ndërtimore;
 - nr. 7458-0; S=24,126.00m²; P.SH. KK Prishtinë; Tokë ndërtimore;
 - nr. 7455-1; S= 7,565.00m²; P.SH. KK Prishtinë; Tokë tjetër;
- Në kuadër të parcelave kadastrale në fjalë, janë të ndërtuara pjesërisht edhe Shkolla Fillore e Mesme dhe e Ulët "Xhemajl Mustafa" si dhe Bibloteka "Hivzi Sulejmani";
- Qasja në parcelat kadastrale në fjalë, përkatësisht në ndërtesë, është përmes rrugës lokale "Ymer Alushani" e asfaltuar;
- Në diametër prej 50m', ndërtesat ekzistuese janë: Ndërtesa të larta të banimit në bashkëpronësi;
- Terreni është kryesisht i rrafshët.



kriteret dhe parimetat urban të Planit Rregullues "Dardania" dhe Planit Zhvillimor Urban, për ndërtimin e ndërtesës së Institucionit Parashkollor / Çerdhes, janë:

- Organizimi, parcela ndërtimore, gabariti, pozita, etazhiteti i ndërtesës, raporti i ndërtesës me vijën rregulluese dhe ndërtimore, rrugët ekzistuese dhe të planifikuara të kompleksit, kyçja e kompleksit në komunikacion, si dhe kushtet tjera, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit - "zgjidhja urbane", bashkëngjitur vendimit të kushteve ndërtimore;
- Qasja në pjesën e paraparë për ndërtimin e Institucionit Parashkollor në fjalë të bëhet nga rruga ekzistuese lokale, e asfaltuar, e cila njëherit është edhe e planifikuar sipas Planit Rregullues "Dardania";
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës në fjalë të jetë Institucion Parashkollor / Çerdhe, Kopsht;
- Etazhiteti i objektit sipas kriterëve të Planit Zhvillimor Urban, për ndërtesat e karakterit të tillë, si dhe bazuar në propozimin e prezantuar është P+1;
- Koeficienti i shfrytëzimi i parcelës ndërtimore (ISHP), brenda vijës rregulluese për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të përdhësës ose suteranit, është max.926.0 m², ndërsa e sipas projektit të propozuar dhe e miratuar është 881.50 m²;;
- Koeficienti i shfrytëzimi të parcelës ndërtimore për nëntokë (ISHPN), brenda vijës rregulluese për vendosjen e objektit në bazë - gabarit të bodrumit lejohet max.60%, bazuar në Vendimin 01nr.031 - 185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, mirëpo sipas projekt propozimit të prezantuar, nuk do të ketë etazhë nëntokësore;
- Sipërfaqja e gjelbëruar e parcelës (ISGJ), duhet të jetë së paku 40%, sipas Vendimit 01 Nr.031-185481 të dt.14.08.2015 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Bazuar në kriteret e PZHU-së, distanca minimale në mes dy ndërtesave është 1H (aty ku ka hapje të kthinave primare), kurse distanca minimale nga kufiri i parcelës kadastrale - parcelës ndërtimore, është 0.75H, gjegjësisht 0.5H me kushtin e mos tejkalimit të distancës në mes dy ndërtesave, prej 1H.
- Vija ndërtimore nuk lejohet të tejkalohet me ballkone, konzolla, shkallë, rampa apo elementet të ngjashme;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Numri i parkingjeve që duhet të sigurohet është 1 VP / 100m², për ndërtesat e kopshteve / çerdheve të fëmijëve;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.
- Gjatë punimeve ndërtimore duhet kujdes i veçantë në mbrojtjen e dobive natyrore.

V. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçe në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;

- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohitorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VI. Dokumentacioni ndërtimor - projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimin Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro - energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;

Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit.

VII. Vlefshmëria e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.

A r s y e t i m

Kërkuesi, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, përmes kërkesës 05 nr.350/02-166770/19 dt.12.07.2019, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor - projektit kryesor, për ndërtimin e ndërtesës së Institucionit Parashkollor / Çerdhes - kopshtit, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit të kushteve ndërtimore.

Bashkangjitur me kërkesë është prezantuar dokumentacioni si në vijim:

- Kopjet e planit dhe certifikatat e njësive kadastrale për parcelat kadastrale nr. 7457-0, 7458-0 dhe 7455-1, ZK Prishtinë;
- Kërkesën me shkrim nga Drejtoria e Arsimit të Komunës së Prishtinës;
- Shkresën 'Aktpërcjellës' të dt.11.07.2019 lëshuar nga Drejtoria e Pronës, mbi lëshimin e Certifikatave të njësive kadastrale dhe kopjeve të planit për parcelat kadastrale në fjalë; si dhe,
- Projekt propozimi për ndërtimin e ndërtesës në fjalë.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, dhe dokumentacionit të bashkangjitur, ka konstatuar se projekti konceptual i prezentuar, është në harmoni me kriteret e Planit në fuqi, andaj, kjo drejtori, bazuar në nenin 13, pika 1.2 të UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt.23.05.2017, ka vendosur njoftimin me datë 08.08.2019. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore, ka qëndruar pesëmbëdhjet (15) ditë në lokacionin në fjalë, dhe meqë ndërkohë kjo drejtori nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo sygjerim, është vazhduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.

Në ndërkohë, përmes kërkesës së aplikuesve, në kuadër të shqyrtimit të kërkesës, me dt.23.08.2019 kjo Drejtori ka lëshuar Pëlqimin për zhvillimin e punimeve, gjegjësisht shpimeve dhe shqyrtimeve gjeomekanike të cilat realizohen nga kompania e specializuar "Geokos".

Bazuar në konstatimet e më sipërme, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L- 110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 13 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezentuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të Planit Rregullues "Dardania" dhe Planit Zhvillimor Urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar

të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore sipas këtij Vendimi.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacionit -"zgjidhja urbane", si dhe ekstrakti nga Plani Rregullues "Dardania" për bllokun në fjalë.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror - MMPH-ja.

Ky Vendim u përpilua në katër (4) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesit, në dosje të lëndës, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

Kopja elektronike e këtij Vendimi i dërgohet: Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS
05.NR. 350/02-166770/19 DT. 20.09.2019


Punoi,
Krenare Shkodra



u.d. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi



AMT
137
CO



	Cerșe (je rogându-se) Beggings (personas)
	Nermbi kalm Piercing
	Lumi Prastieva Kobolot'i Iuri Prastieva Problems with diabetes
	Kufuri pînă la regulă Regular pills (monthly)
	Via regulative Via sedintore Consultation fees
	Kufuri bîcăt Bitch (sland)
	Parcela Parcel

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA
KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E PRISHTINËS/OPSTINA
PRISTINA/MUNICIPALITY OF PRISTINA

DREKTORIA E URBANIZMIT, KADASTRES DHE MBROJTJES SE MJEDISIT
THE DEPARTMENT OF URBANISM, CADASTRE AND ENVIRONMENT PROTECTION



ZGJIDHJA URBANE

PLANI RREGULLUES "DARDANIA"
Regulatory plan "DARDANIA"
Regulacioni plan "DARDANIA"

CONCLUSIONS

SHTOJCA GRAFIKE PËR BLOKUN 9a

PROPERTIES





VĚSTFON

**DREJTORI DREKTORATIT TE URBANIZMIT, KADASTRES DHE MISOJUTJES SË MUJESIT
dipl.inj. SHQIRI SPANU**

KRYETARI I KUVENDIT KOMUNAL TË PRISHTINËS
Prof.dr. ISA MUSTOFA

May 2008



TOTAL AREA		
Number	Name	Area
1-01	Sleeping Area (2-3 years 15)	312 m ²
1-02	Laundry & Storage	Not Placed
1-03	Classroom (2-3 years / 15)	54.3 m ²
1-04	Toilets	8.9 m ²
1-05	Classroom (0.9-2 years 10)	41.5 m ²
1-06	Toilet	5.6 m ²
1-07	Classroom (0.9-2 years 10)	41.5 m ²
1-08	Toilet	5.6 m ²
1-09	Classroom (2-3 years / 15)	54.3 m ²
1-10	Toilets	8.9 m ²
1-11	Sleeping Area (2-3 years 15)	312 m ²
1-12	Parent Teacher Conf	31.4 m ²
1-13	Director Of.	15.6 m ²
1-14	Paediatrician's Of.	15.2 m ²
1-15	Technic	5.3 m ²
1-16	Cleaning	4.4 m ²
1-17	Dis. Toilet	4.8 m ²
1-18	Toilet	3.7 m ²
1-19	Toilet	3.7 m ²
1-20	Nurses' Of.	14.4 m ²
1-21	Secretary	13.8 m ²
1-22	Milk Room	9.7 m ²
1-23	Toilets	7.2 m ²
1-24	Classroom (0.9-2 years 10)	40.6 m ²
1-25	Corridor	237.9 m ²
1-26	Stair	Not Placed
1-27	Fire Es. Stair	15.5 m ²
1-28	Laundry & Storage	12.4 m ²
1-31	Stair	22.1 m ²
G-01	Sleeping Area (3-4 years 22)	45.4 m ²
G-02	Classroom (3-4 years 22)	72.4 m ²
G-03	Toilets	9.7 m ²
G-04	Sleeping Area (3-4 years 16)	31.6 m ²
G-05	Classroom (3-4 years 16)	54.4 m ²
G-06	Toilets	8.9 m ²
G-07	Classroom (4-5 years 22)	72.2 m ²
G-08	Toilets	9.5 m ²
G-09	Sleeping Area (4-5 years 22)	45.4 m ²
G-10	Waiting / Reception	30.9 m ²
G-11	Wardropes	61.3 m ²
G-12	Storage	3.9 m ²
G-13	Technic	5.3 m ²
G-14	Security Room	9.6 m ²
G-15	Dis. Toilet	4.6 m ²
G-16	Corridor	13.6 m ²
G-17	Cleaning	3.6 m ²
G-18	Toilet	3.4 m ²
G-19	Toilet	3.5 m ²
G-20	KITCHEN	31 m ²
G-21	Str. Food	12.8 m ²
G-22	Toilet	11.4 m ²
G-23	Servis Ent.	11 m ²
G-24	Technic	4.6 m ²
G-25	Storage	Not Placed
G-25	Storage	8.9 m ²
G-26	MultiPurpose / Dining Area	119.5 m ²
G-27	Dinnin Room	4.7 m ²
G-28	Stair	Not Placed
G-28	Stair	11.7 m ²
G-29	Corridor	59.4 m ²
G-30	Storage	6.9 m ²
G-31	Fire Es. Stair	8 m ²
G-32	Canopy	18.1 m ²
Grand total: 63		1622.3 m ²

Contracting Authority



European Union
Kosovo

An EU funded project managed by the European Union Office in Kosovo

Identification Number :

EuropeAid / 138777 / DH / SER / XK - Re Launch

Beneficiary

Prishtina P-71914059-07455-1

Project Title

Design And Supervision Of Kindergartens

Category

Preliminary Design

Arc

Drawing Title

Site Plan

Drawing Scale

1 : 500

Format

A2

Revision Number

R03

Drawing Number

000

PR
UR
KO